



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 106 prot

Tiranë, më 18.022025

VENDIM

Nr. 1 datë 18.022025

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 18/2/2025

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe në VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, të mbledhjes së datës 18.2.2025 vendosi:

1. Për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.450, datë 26.07.2018 të Këshillit të Ministrave “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritetit evropian, ndërmjet Qeverisjes Qendrore dhe Njësitëve të Vetëqeverisjes Vendore”, propozuar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
 - të shtohet në projektvendim ndërveprimi me njësitë e performancës dhe roli i Shoqatës për Autonomi Vendore.
2. Për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2025-

2030 dhe planit të veprimit”, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ u shprehën parimisht dakord me projektvendimin.

3. **Për projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 784, datë 18.12.2024 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe zhvillimin e zonave aeroportuale”,** propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Të përcaktohen qartë në Planet e Përgjithshme Vendore të bashkisë se cila është zona e mbrojtur Aeroportuale.
- Të përcaktohet se për cilat leje është përgjegjëse Njësia e Vetëqeverisjes Vendore dhe në cilat raste duhet të kërkojë mendim nga AAC

Pika 2, të ndryshohet si më poshtë:

- “2. Zonë e mbrojtur ajrore është hapësira ajrore përreth aerodromeve, e cila duhet mbajtur e lirë nga pengesat, duke lejuar që operimet e mjeteve ajrore të kryhen në mënyrë të sigurt, të parandalojnë që aerodromet të bëhen të pashfrytëzueshëm nga shtimi i pengesave përreth tyre, si dhe të sigurojnë që projektet zhvillimore të ndërtimit në zonat e përcaktuara, në asnjë formë, të mos shkelin kërkesat e sigurisë së lundrimit ajror dhe të jenë në përputhje me operimet në aerodrom.
- Përcaktimi i zonës së mbrojtur të aeroportit, kushtet dhe kriteret e zhvillimit dhe ndërtimit në këtë zonë dhe territorit përreth saj bëhen sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
- Në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë ajrore dhe standartet ndërkombëtare të aviacionit civil, zona e mbrojtur e aeroportit ndahet në disa nënzona sipas hartës treguese bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.”

Pika 6, të ndryshohet si më poshtë:

- “6. Lejet e ndërtimi/zhvillimi, brenda zonës së mbrojtur të aeroportit, nuk miratohen pa pëlqimin e AAC-së, pas marrjes parasysh të mendimit zyrtar të entit menaxhues të aeroportit.
- Lejet për zhvillim/ndërtim në zonat e mbrojtura të aeroportit shqyrtohen nga autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e territorit, sipas rregullave të përcaktuara në Aneksin 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi, si dhe në përputhje me parashikimet e vendimit nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar.”

Pika 13 të ndryshohet si më poshtë:

- “13. Në çdo rast, subjektet që kërkojnë të bëjnë zhvillime ose ndryshime në pasuritë apo objektet që kanë në pronësi, duhet të ndjekin procedurën e parashikuar në

vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, sipas rregullave të përcaktuara në pikën 6 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.”

Pas pikës 15 të shtohet pika 16, si më poshtë:

- “16. Detyrimet e përcaktuara në këtë akt zbatohen vetëm për lejet e zhvillimit/ndërtimit që do të shqyrtohen pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi”.

Z. Arbjan MAZNIKU
Ministër Shtet për Pushtetin Vendor

Z. Aldrin DALIPI
Kryetar/Bashkëkryetar
Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë

